



I	Data 25.04.24	Vendi KAÇANIK
Nj. org.	Numri	Shtojcë
04	610/01	9820



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

Komuna e Kaçanikut

Opština Kaçanik/Municipality of Kaçanik



Kaçanik, 25.04.2024

Duke u bazuar në Rregulloren MF- Nr. 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, Komuna e Kaçanikut-Drejtoria e Arsimit shpall këtë:

Thirrje publike për ofrimin e mbështetjes financiare publike për financimin e projekteve/ programeve të OJQ-ve

- Drejtoria për Arsim e Komunës së Kaçanikut, u bënë thirrje të gjitha organizatave jo-qeveritare të regjistruara në Republikën e Kosovës, programi i punës i të cilave është fokusuar në fushën e zhvillimit të trajnimeve të aplikojnë për mbështetje financiare për projektet që kontribuojnë në zhvillimin e projekteve arsimore.
- Vlera totale e planifikuar e thirrjes është 3,600.00 euro
- OJQ-të në përputhje me këtë thirrje publike mund të aplikojnë me projektet/programet e tyre për fushat prioritare:
 - Të gjitha OJQ-të programi i të cilave është i fokusuar në fushën e arsimit
 - Të gjitha OJQ-të fushëveprimtarisë së cilave është e fokusuar në zhvillimin e trajnimeve
- OJQ- të në përputhje me këtë thirrje publike mund të aplikojnë në më së shumti dy fushat e mëposhtme:
 - Zhvillimi I trajnimeve në fushën e Gjithëpërfshirjes*
 - Zhvillimi I trajnimeve për Zhvillimin dhe Mendimin Kritik*
 - Zhvillimi I trajnimeve për Metodologjitë e reja të Mësimdhënies*
 - Zhvillimi I trajnimeve për hartimin dhe zhvillimin ne Planit Individual të Arsimit*
 - Zhvillimi I trajnimeve në Përdorimin e teknologjisë për zhvillimit e orës mësimore*
 - Zhvillimin e trajnimeve për Mësimdhënien e Diferencuar*
 - Zhvillimin e tranimeve në fushën e vlerësimit*
- OJQ-të të cilat aplikojnë në përputhje me këtë thirrje publike duhet të dorëzojnë dëshminë e Vertetimit tatimor, të kenë filluar veprimtarinë së paku një vit para datës së publikimit të kësaj thirrje publike dhe duhet të dorëzojnë dëshmi të veprimtarisë dhe zhvillimit të trajnimeve- Referenca.
- Afati i fundit për dorëzimin e propozimeve (aplikacioneve) është 15 ditë pune, fillon me datën 26.04.2024 dhe përfundon me datën 17.05.2024.

Para nënshkrimit të kontratës, OJQ duhet të paraqesë prova se personi përgjegjës në OJQ dhe menaxheri i projektit nuk janë nën hetime për vepra penale, si dhe prova se OJQ-ja ka zgjidhur çdo çështje të hapur rreth pagesës së kontributeve dhe tatimeve të papaguara, nëse është e aplikueshme.

Propozimet do të dorëzohen vetëm në formularët e paraparë, të cilat janë në dispozicion në faqen e internetit të ofruesit të mbështetjes financiare, webfaqja:

<https://kk.rks-gov.net/kacanik/category/konkurset-njoftimet/>

(rubrika: ***SHPALLJET***)

Dokumentet e kompletuara duhet të dorëzohen tek:

Objekti i Komunës, sporteli nr. 8, kati i Parë

Do të konsiderohen për mbështetje financiare vetëm projektet që janë pranuar brenda afatit të paraparë me këtë thirrje publike dhe të cilat i përmbushin plotësisht kushtet e përcaktuara të thirrjes publike.

Kryetari i Komunës

z. Besim Hazi



[Handwritten signature]